



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1212/2 prot.,

Datë 30.05.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “TIMAC” SHPK, “Power Industries” SHPK, “ARTEO 2018” SHPK, “NGRACAN 1934” SHPK, “SPARKLE 32” SHPK dhe “TIRES-R” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-65213-04-06-2023, me objekt: “Blerje kontenier dhe kosha metalik për mbetjet urbane”, me fond limit 16.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.04.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pastrimit Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “LUAR Bros” SHPK
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati 2, Ap.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Pastrimit Fier
Adresa: Lagja “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aranitasi” Fier.

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “TIMAC” SHPK
Adresa: “Tirana Industrial Park”, Nr. 37, Rruga “Egnatia” Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “Power Industries” SHPK
Adresa: Zona Kadastrale Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143 Sipërfaqe Totale 2610 m2, Picar, Vorë, Tiranë.

Operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK

Adresa: Lagjja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Aqif Pasha", Hotel "Skampa", Kati 5, Nr.303, Elbasan.

Operatori ekonomik "NGRACAN 1934" SHPK
Adresa: Lagjja "Sheq i Madhe", Rruga "Koçi Papuciu" Banese private Nr 53, Fier.

Operatori ekonomik "SPARKLE 32" SHPK
Adresa: Lagjja "Frutikulturë", Rruga "Bulevardi Blu", Ndërtese private Nr.115, Kamëz, Tiranë.

Operatori ekonomik "TIRES-R" SHPK
Adresa: Rruga "Iliria", Ndërtesë Private, Zona Kadastrale Nr.1649, Numër Pasurie 28/26, Kamëz, Tiranë.

Në datën 29.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1212/2023 protokollin e operatorit ekonomik "LUAR Bros" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-65213-04-06-2023, me objekt: "Blerje kontenier dhe kosha metalik për mbetjet urbane", me fond limit 16.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.04.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pastrimit Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë "TIMAC" SHPK, "Power Industries" SHPK, "ARTEO 2018" SHPK, "NGRACAN 1934" SHPK, "SPARKLE 32" SHPK dhe "TIRES-R" SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma "c" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: "Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime."

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik "LUAR Bros" SHPK, në ankesën me nr. 1212 prot., datë 29.05.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë "TIMAC" SHPK, "Power Industries" SHPK, "ARTEO 2018" SHPK, "NGRACAN 1934" SHPK, "SPARKLE 32" SHPK dhe "TIRES-R" SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorëve ekonomikë "TIMAC" SHPK, "Power Industries" SHPK, "ARTEO 2018" SHPK, "NGRACAN 1934" SHPK "SPARKLE 32" SHPK dhe "TIRES-R" SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

“Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*
- *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*
- **Shënim:** *Bashkimi i operatoreve ekonomike qe do te rezultoj fitues, pas procedures se prokurimit do te dorezoje prane AK, para lidhjes se kontrates dokumentacionin si me poshte (ne perputhje me pikën 2, të nenit 14, të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”):*
 - a. *Marrëveshja **e noterizuar**, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*
 - b. *Prokura e posaçme **e noterizuar**. ”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri